| 34 | 05.02.2024 | Pershendetje ! Mund te me dergoni faturen per pagesen e tarifes studentore .Universiteti i Vlores ,dega Gjuhe Shqiper Letersi | 12.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përputhje me ligjin nr.119/2014, i ndryshuar bashkelidhur ju përcjellim për kopetence kerkesën e studentes.<br>Faleminderit, | Kekesa eshte deleguar per kopetence sipas nenit 12 te ligjit nr.119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar. | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 35 | 06.02.2024 | Pershendetje!<br>Un kam perfituar bursen nga deget prioritare, menaxhim turizmi, por kisha paqartesi ne lidhje me marrjen e diplomes dhe nese mesatarja bie.<br>Per diplomen duhet te pres 3 vite pas universitetit, apo e marr ne daten qe cakton vet universiteti te bej diplomimin?<br>Dhe nese mesatarja bie sadopak, bursa nderpritet por gjithsesi me duhet te ndjek ligjin dhe te qendroj 3 vite ketu?<br>Ju lutem me sqaroni per keto paqartesi.<br>Faleminderit! | 15.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se:<br>Në mbështetje të VKM nr.386/2022, të ndryshuar, për të përfituar dhe vijuar përfitimin e mbështetjes financiare, studentët përfitues të cilët ndjekin studimet në programe prioritare nuk kanë asnjë detyrim në lidhje me ruajtjen e notës mesatare.<br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 36 | 07.02.2024 | A esht ber rishikimi I burasave? | 12.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj pwr informacion, konstatojmë se objekti i saj është i paqartë.<br>Sa më sipër, lutemi nga ana juaj qartësimin e këkrkesës tuaj me qëllim infromimin nga ana jonë.<br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 37 | 09.02.2024 | Përshendetje!Jam një studente nga viti i parë Gjuhë/Letërsi në Durres.Doja te më ndihmonit me nje informacion më te "saktë"ne lidhje me bursat që u bën...Kishit zgjedhur 3 vjaza nga kjo degë pra me mesataret më të larta,por nje nga vajzat nuk e pranoi këtë pra nuk e donte bursen.Tani ajo të cilën un dua të dij është se a e përfiton dikush tjetër nga klasa me mesataren me te larte meqe njera nga vajzat u "tërhoq"?Ju lutem merreni në konsideratë këte email! | 12.02.2024 | Përshëndetje<br>Në përgjigje të këkrkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se:<br>Në mbështetje të pikës 6/1, të VKM nr. 386/2022, të ndryshuar, përzgjedhja e studentëve përfitues për programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, bëhet nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë me Vendim të Senatit Akademik, sipas kuotave të miratuara çdo vit për mbështetje financiare, për çdo IAL publike.<br>Sa më sipër, ju mund të drejtoheni pranë IAL-së në të cilin ju ndiqni studimet për më tepër informacion.<br>Ju falemiderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 38 | 09.02.2024 | Përshëndetje, shpersoj që ky email t'ju gjejë sa më mirë. Jam R.D nxënse tek Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" Fakulteti i Shkencave të Natyrës Dega Matematikë, dhe ju shkruaj në lidhje me përfitimin e bursës për degët prioritare dhe premtimin e bërë nga Ministria e Arsimit për të gjith studentët që ndjekin këto degë. Në faqen e internetit te UNISHK me Dt.05/02/2024 është ngarkuar një listē me përfituesit por tek kjo listë është vetëm një emër i përzgjedhur kur ka dhe shumë nxënës të tjerë që i plotësojn kriteret e paracaktuara nga ju (këtu përfshirë dhe veten time). Kur kemi bërë aplikikimin kemi qënë nën idenë që çdo nxënës që plotëson kriteteret do të jetë përfitues, ne nuk na ka ardhur asnjë komunikim zyrtar nga universiteti për ndryshimin e këtyre kushteve dhe deri tani kemi pasur përshtypjen që premtimi i bërë nga ana juaj do të mbahej. Ky premtim na ka penalizuar edhe për të aplikuar për bursa të tjera duke mbajtur besimin tek fjala juaj! Kjo bursë është shumë e rëndësishme për mua pasi un gjithashtu trajtohem me ndihmë ekonomike dhe nuk jetoj në qytetin e Shkodrës gjë e cila ma vështirëson edhe më shumë ciklin e studimit dhe meqenëse afatet për të aplikuar për mbështetje të tjera financiare ka përfunduar nuk kam zgjedhje tjetër veç se t' ju dejtohem juve me pyetjen: Pse matematika ka vetëm një kuotë kur është një ndër degët më në rrezik?<br>Shpresoj shumë që të rishikoni edhe një herë vendimin tuaj sepse në sytë tanë duket i padrejtë dhe duhej të ishte komunikuar para aplikimit .<br>Ju lutem të më ktheni përgjigje!<br>Faleminderit, | 12.02.2024 | Përshëndetje<br>Në përgjigje të këkrkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se:<br>Në mbështetje të pikës 6/1, të VKM nr. 386/2022, të ndryshuar, përzgjedhja e studentëve përfitues për programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, bëhet nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë me Vendim të Senatit Akademik, sipas kuotave të miratuara çdo vit për mbështetje financiare, për çdo IAL publike.<br>Sa më sipër, ju mund të drejtoheni pranë IAL-së në të cilin ju ndiqni studimet për më tepër informacion.<br>Ju falemiderit, | Informacioni eshte i pjesshem. Kekesa eshte deleguar per kopetence sipas nenit 12 te ligjit nr.119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar. | JO |
| 39 | 10.02.2024 | Pershendetje<br>Si jeni?<br>Une kam aplikuar per burse pasi studjoj ne dege prioritare ne Elbasan por nuk me eshte miratuar. A mund te di arsyen perse?<br>Faleminderit! | 12.02.2024 | Përshëndetje<br>Në përgjigje të këkrkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se:<br>Në mbështetje të pikës 6/1, të VKM nr. 386/2022, të ndryshuar, përzgjedhja e studentëve përfitues për programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, bëhet nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë me Vendim të Senatit Akademik, sipas kuotave të miratuara çdo vit për mbështetje financiare, për çdo IAL publike.<br>Sa më sipër, ju mund të drejtoheni pranë IAL-së në të cilin ju ndiqni studimet për më tepër informacion.<br>Ju falemiderit, | Informacioni eshte i pjesshem. Kekesa eshte deleguar per kopetence sipas nenit 12 te ligjit nr.119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar. | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 40 | 12.02.2024 | Pershendetje! Sot morem vesht se kush, kishte perfituar bursën prioritare ne shkoder, dhe ishin vetem 14 vetë qe e kishin fituar kur me pare keni thene qe te gjith ata qe aplikojne ne degë prioritare do te perfitojne bursën, dhe tarifen vjetore falas. Çfare eshte kjo padrejtsi qe po na beni ne studenteve ? Dhe perse vetem studentat me mesataren e lart duhet ta fitojne ? | 15.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të ankesës tuaj ju informojmë se:<br>Përzgjedhja e studentëve përfitues të mbështetjes financiare realizohet me Vendim të Senatit Akademik të IAL-së, sipas procedurës të parashikuar në pikën 6/1 të VKM nr.386/2022, të ndryshuar.<br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 41 | 12.02.2024 | Përshëndetje,<br>Jam njoftuar më datë 8 janar se plotësoj kushtet për përfitimin e mbështetjes financiare si studente e shkëlqyer.<br>Do të doja të dija nëse duhet të interesohem pranë universitetit për hapat që duhen ndjekur në vazhdim, apo do të njoftohem nga stafi juaj.<br>Faleminderit! | 14.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se, ju do të njoftoheni nga Universiteti pranë të cilit jeni duke ndjekur studimet, mbi vijimin e procedurave përkatëse.<br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 42 | 12.02.2024 | Pershendetje qendra AKFAL.<br>Une qe po ju shkruaj jam S.Aj, nje studente ne vitin e dyte bachelor, studioj ne degen e Biologjise. Vitin e kaluar e perfitova kete burse me mesataren 8.5 , te notave ne gjimnaz, ndersa vitin e pare ne universitet e nxorra me burse 9.4.<br>Do te doja te dija nese e perfitoj dhe kete bursen dhe a duhet t'ju dergoj perseri liste notash? Ju lutem me ktheni nje pergjigje.<br>Ju faleminderit! | 14.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, bashkëlidhur ju ri-dërgojmë, njoftimin e bërë nga AKFAL, për vijimin e përfitimit të mbështetjes financiare, nga ana juaj edhe për vitin akademik 2023-2024, në zbatim të marrëveshjes tre-palëshe të nënshkruar në viti akademik 2022-2023.<br>Sa më sipër, si dhe referuar përcaktimeve në Udhëzimin nr.30 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Marrëveshje Tre-palëshe, ju e keni depozituar në mujain tetor 2023 dokumetacionin e nevojshëm.<br>Ju falemiderit. | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 43 | 14.02.2024 | Pershendetje si jeni<br>Jam fituese e burses me lende prioritare ne universitetin e Gjirokastres<br>Me jane kerkuar te dhenat e kartes te bankes<br>Si eshte procesi radhes? Duhen te dhena te tjera si behet pagesa. Faleminderit paraprakisht | 27.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije se, ju duhet të dorëzoni të dhënat e llogarisë bankare, pranë Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastër, .<br>Ju faleminderit! | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 44 | 18.02.2024 | Pershendetje,<br>Ju kontaktoj lidhur me bursen sa paga minimale per studentet ekselente.<br><br>Mund te kemi informacion per me tutje, domethene si duhet te procedojme apo te informohemi nese jemi perfitues te burses apo jo?<br><br>Faleminderit! | 29.02.2024 | Përshëndetje,<br><br>Sipas Vendimit të Bordit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, ju jeni miratuar si studete përfituese e mbështetjes financiare, sipas kriterit 2/a të VKM nr.386/2022, të ndryshuar, për vitin akademik 2023-2024, në programin e studimit "Mjekësi e Përgjithshme", Universiteti i Mjekësisë Tiranë.<br><br>Ju duhet të paraqiteni pranë Universitetit tuaj për nënshkrimin e marrëveshjes tre-palëshe.<br><br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 45 | 18.02.2024 | Pershendetje<br>Une jam nje student qe perfitoj bursen e ekselences, ne vit te 2 ne universitet, pasi kam ruajtur mesataren mbi 9.5 ne vit te pare.<br>Ne rast se arrij ta ruaj kete mesatare edhe ne vit te dyte, a mundet qe te zgjedh te mos te marr bursen 400 mije leke, por t'i kthej keto leke qe kam marre e te zgjedh bursen 100 mijeshe (ose ndonje burse tjeter "pa kthim")?<br>Lutem per nje pergjigje si te veproj.<br>Faleminderit | 29.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj ju informojmë se:<br>Në nenin 5 të marrëveshjes 3-palëshe që ju keni nënshkruar, (AKFAL-IAL-Student), "Kthimi i masës së financimit", përkatësisht në pikën 2 dhe 3 përcaktohet se:<br>2. Në çdo moment, pas nënshkrimit të marrëveshjese deri në përfundimin e efekteve të saj,përfituesi ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim, drejtuar dy paleve të tjera të marrëveshjes, për zgjidhjen e kësaj marrëveshje, duke qënë i detyruar të kthejë 100% të përfitimit financiar të marrë deri në momentin e prishjes së marrëveshjes. Në rast se zgjidhja e marreveshjesbëhet nga përfituesi pas diplomimit, përfituesi , pasi të ketë kthyer të gjithë masën e financimit, ka të drejtë të pajiset me diplomën origjinale nga IAL apo punëdhënësi i fundit<br>3. në rastet e parashikuara në këtë dispozite për kthimin e masës së financimit, përfituesi duhet t'i kthejë ministrisë përgjgëse për arsimin shumën e përfituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e njoftimit nga ministria. Në rast të moskthimit të shumës apo refuzimit nga ana e përfituesit, brenda këtij afati, ndiqen procedurat ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, sipas legjislacionit në fuqi.<br>Sa më sipër ju mund të zgjidhni të mos e merrni më financimin duke e kthyer atë në masën 100% , per aq sa keni perfituar deri më momentin e prishjes së kësaj marrëveshje.<br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 46 | 19.02.2024 | Pershendetje Akfal,<br>Kisha nje pyetje ne lidhje me kontraten e firmosur nga studentet ekselente per mbeshtetjen financiare.<br>Une jam nje perfituese dhe desha te di nese diploma origjinale do na dorezohet fiks pas 3 vitesh nga dita e diplomimit apo pasi te kemi kryer 3 vite pune ne sektorin shteteror (domethene duke mos marre parasysh kohen qe mund te kemi qendruar pa pune pas diplomimit) ?<br>Do ju isha falenderuese nese do me sqaronit. | 29.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se:<br>Në mbështetje të VKM nr.386/2022, të ndryshuar, përcaktohet detyrimi i studentit që ka përfituar financim, që të punojë në profesionin për jo më pak se 3 vite ne institucionet publike.<br>Në rast se studenti ka përmbushur detyrimet (pra te keni punuar në profesionin për jo më pak se 3 vite), ju lind e drejta e tërheqjes së diplomës origjinale nga institucioni publik i arsimit të lartë ku ka përfunduar studiment e financuara, sipas këtij vendimi.<br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 47 | 19.02.2024 | Pershendetje ku duhet me u paraqit neser per te firmos kontratën | 28.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije se për nënshkrimin e marrëveshjes 3-palëshe si përfitues i Mbeshtetjes Financiare, ju duhet të praqiteni pranë Universitetit ne te cilin jeni shpallur fituese.<br>Ju faleminderit! | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 48 | 20.02.2024 | Përshëndetje!<br>Shkova sot per nenshkrimin e marreveshjes tek universiteti por ata nuk kishin asnje informacion per kete pjese. Ju lutem a mund te me informoni me sakte se si do te procedohet.<br>Faleminderit. | 28.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije se për nënshkrimin e marrëveshjes 3-palëshe si përfitues i Mbeshtetjes Financiare, ju duhet të paraqiteni pranë Universitetit ne te cilin jeni shpallur fituese.<br>Ju faleminderit! | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 49 | 21.02.2024 | Pershendetje! Isha i interesuar per kredine studentore . Mund te me jepni informacion per interesin dhe si fuksionon e gjitha Faleminderit | 27.02.2024 | Pershendetje,<br>Ne pergjigje te pyetjes tuaj, ju informojme se, referuar VKM 440/2023,  studenti i cili ploteson kriteret e percaktuar ka te drejte te aplikoje per kredi studentore per te financuar  kostot e studimeve.   Kostoja e studimeve, përfshin tarifën e studimeve dhe kostot e jetesës. Kostot e jetesës përllogariten deri në kufirin e pagës minimale në shkallë vendi.<br>AKFAL financon një pjesë të normës së interesit të kredive studentore, që banka do të kontraktojë me studentët te cilet do te shpallen fitues. Banka qe eshte shpallur fituese per ofrimin e kredise studentore eshte banka e nivelit te dyte Intesa Sanpaolo. Kredia studentore jepet pa kolateral fizik.<br>Detyrimi i shlyerjes së kredisë, përfshirë principalin dhe interesin e kredisë nga studenti kredimarrës, fillon;<br>jo më herët se 3 (tre) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të parë;<br>jo më herët se 2 (dy) vjet pas nënshkrimittë kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të dytë dhe<br>jo më herët se 5 (pesë) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të integruar të ciklit të dytë.<br>Per ndonje paqartesi/per me shume informacion mund te na kontaktoni perseri.<br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 50 | 21.02.2024 | Pershendetje!Jam Sibora Balla,studente nga universiteti i  Vlores Ismail Qemali.Me ka ardhur njoftimi me email si perfituese e burses si ekselente,por universiteti thote qe nuk ka njoftim dhe bursa eshte vetem per deget prioritare.Ju lutem pres nje pergjigje prej jush! | 29.02.2024 | Përshëndetje,<br>Sipas Vendimit të Bordit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, ju jeni miratuar si studete përfituese e mbështetjes financiare, sipas kriterit 2/a të VKM nr.386/2022, të ndryshuar, për vitin akademik 2023-2024, në programin e studimit "Finance", Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.<br>Ju duhet të paraqiteni pranë Universitetit tuaj për nënshkrimin e marrëveshjes tre-palëshe.<br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 51 | 21.02.2024 | Pershendetje!<br>Une qe po ju shkruaj jam Antela Lika , gazetare ne emisionin Fiks-Fare.<br>Ne redaksine tone kane ardhur ankesa nga studente te degeve prioritare te Universitetit Bujqesor te Tiranes, te cilet nuk po marrin pagesen.<br>Universiteti ne pergjigjet per studentet thote qe e di ministria.<br>Ndaj duam te dime nese jane rivendosur kritere per perfitimin e kesaj pagese?<br>A po zbatohet VKM-ja?<br>Ministrja e asaj kohe tha se do hiqet kriteri i mesatares per keto dege, a eshte rivendosur ky kriter?<br>Faleminderit!<br>Ne pritje te pergjigjes suaj! | 26.02.2024 | Përshendetje,<br>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju sqarojmë si më poshtë:<br>Me Vendimin nr.2, datë 08.02.2024 të Bordit Drejtues të AKFAL-it është miratuar lista përfundimtare me të gjithë studentët që ndjekin studimet në programet prioritare,të cilët përfitojnë Mbështetje Financiare për vitin akademik 2023-2024, sipas Vendimeve të Senatave Akademike të IAL-ve, si dhe Fondin përkatës për cdo IAL.<br>Ne mbështetje të VKM nr. 386, datë 01.06.2022,” Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në Institucionet Publike të Arsimir të Lartë”, në pikën 2 gërma”c” , percaktohet se e përfiton mbështetjen financiare studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar. Studenti i cili ka zgjedhur të ndjekë studimet në një prej programeve të studimit, sipas emërtimeve në listën e programeve prioritare të miratuar me shtojcën nr.1 të VKM nr. 386/2022, të ndryshuar,, përfiton mbështetjen financiare dhe mund të vijojë perfitimin pavarësisht notës mesatare. Pra nuk kemi ndryshim të kritereve.<br>AKFAL ka realizuar procesin për përfitimin e Mbështetjes Financiare, per vitin akademik 2023-2024, ne përputhje me VKM nr 386/2022, te ndryshuar dhe udhëzimin nr. 30/2022, te Ministrit te Arsimit dhe Sportit.<br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 52 | 22.02.2024 | Pershendetje jam nje student i deges se historise ne fakultetin e Shkodres kam aplikuar per bursen prioritare , se i deges prioritare desha se perse nuk e perfitoj , se kam plotesuar kriterin c per bursen prioritet kombetar dhe jo per studentat ekselenta . neqofte nuk zgjidhni kete do t'i shkruaj ministres se arsimit se edhe ne mature nuk deshen per te ma dhene bursen bashkia dhe i shkruva leter ministres se arsimit , prandaj mundesisht me ktheni sa me pare pergjigje .Indrit Arben Dardhanjori | 28.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije se:<br>Sipas pikës 6/1, të VKM nr.386, datë,01.06.2022, i ndryshuar, përzgjedhja e studentëve përfitues për programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, bëhet sipas kuotave të miratuara çdo vitpër mbështetje finaciare, për çdo IAL publike, nga ministri përgjegjës për arsimin dhe fondit në dispozicion për vitin përkatës financiar.<br>Institucionet publike të arsimit të lartë i caktojnë këto kuota me vendim të Senatit Akademik për çdo program prioritar që ato ofrojnë, në përpjestim të drejtë me numrin e studentëve për çdo program dhe i përzgjedhin ato në bazë të renditjes, sipas notës mesatare në pranim,nëse numri i kërkuesve është më i madh se kuotat e ofruara.<br>Sa më sipër, perzgjedhja eshte realizuar nga Universiteti " Luigj Gurakuqi", Shkodër, për studentët përfitues për programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar me Vendim te Senatit Akademik te tij.<br>Ju Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 53 | 22.02.2024 | Pershendetje jam një student nga Korça, në vitin e parë, i cili ka fituar bursen per degët prioritare dhe gjatë shqyrtimit të kontratës që ka ardhur kam qënë i paqartë per Nenin 4, piken 2b në lidhje me kriterin e notes mesatare që duhet të ruaj, doja të dija se cili është ky kriter i notes mesatare të cilin nëse nuk e ruaj humbas bursën per vitin e dytë. Ju lutem me ktheni pergjigjje! Faleminderit! | 28.02.2024 | Përshëndetje,<br>Sipas VKM nr.386 datë 01.06.2022, përfitues i Mbështetjes Financiare gërmës "c", pika 2, studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar nuk ka detyrimin e ruajtjes së notës mesatare me qellim vijimin e perfitimit te mbeshtetjes ne vitet pasardhese.<br>Ju faleminderit! | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 54 | 22.02.2024 | Pershendetje! Isha i interesuar per kredine studentore. Mund te me jepni informacion ne lidhje me interesin dhe si funksionon ne teresi? Faleminderit | 26.02.2024 | Pershendetje,<br><br>Ne pergjigje te pyetjes tuaj, ju informojme se, referuar VKM 440/2023, studenti i cili ploteson kriteret e percaktuar ka te drejte te aplikoje per kredi studentore per te financuar kostot e studimeve. Kostoja e studimeve, përfshin tarifën e studimeve dhe kostot e jetesës. Kostot e jetesës përllogariten deri në kufirin e pagës minimale në shkallë vendi.<br><br>AKFAL financon një pjesë të normës së interesit të kredive studentore, që banka do të kontraktojë me studentët te cilet do te shpallen fitues. Banka qe eshte shpallur fituese per ofrimin e kredise studentore eshte banka e nivelit te dyte Intesa Sanpaolo.<br>Detyrimi i shlyerjes së kredisë, përfshirë principalin dhe interesin e kredisë nga studenti kredimarrës, fillon;<br>jo më herët se 3 (tre) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të parë;<br>jo më herët se 2 (dy) vjet pas nënshkrimittë kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të dytë dhe jo më herët se 5 (pesë) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të integruar të ciklit të dytë.<br>Per ndonje paqartesi mund te na kontaktoni perseri.<br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 55 | 22.02.2024 | Pershendetje jam një student nga Korça, në vitin e parë, i cili ka fituar bursen per degët prioritare dhe gjatë shqyrtimit të kontratës që ka ardhur kam qënë i paqartë per Nenin 4, piken 2b në lidhje me kriterin e notes mesatare që duhet të ruaj, doja të dija se cili është ky kriter i notes mesatare të cilin nëse nuk e ruaj humbas bursën per vitin e dytë. Ju lutem me ktheni pergjigjje! Faleminderit! | 26.02.2024 | Përshëndetje,<br>Sipas VKM nr.386 datë 01.06.2022, përfitues i Mbështetjes Financiare gërmës "c", pika 2, studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar nuk ka detyrimin e ruajtjes së notës mesatare me qellim vijimin e perfitimit te mbeshtetjes ne vitet pasardhese.<br>Ju faleminderit! | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 56 | 24.02.2024 | Pershendetje. Une jam nje student i cili studioj ne fakultetin Ismail Qemali Vlore ne degen e infermierise se pergjithshme. Jam viti 2. Pashe qe keni nisur hapur aplikime per kredi studentore. Une nuk kam mundesi ta paguaj tarifen e studimit kete vit dhe a mund te aplikoj per kredi studentore? | 26.02.202 | Pershendetje,<br><br>Ne pergjigje te pyetjes tuaj, ju informojme se, sipas VKM 440/2023, çdo student me shtetesi dhe vendbanim ne shqiperi, qe ndjek studimet ne nje institucion te arsimit te larte ka te drejte te aplikoje per kredi studentore, per te financuar kostot e studimit.<br><br>Kostoja e studimeve, për efekt të masës së kredidhënies, përfshin tarifën e studimeve dhe kostot e jetesës. Kostot e jetesës përllogariten deri në kufirin e pagës minimale në shkallë vendi,të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.<br><br>Per me shume informacion na kontaktoni perseri.<br><br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 57 | 26.02.2024 | Përshëndetje! Jam përfituese e bursës për degën prioritare dhe dëshiroj të jem pak më e qartë në lidhje me pjesën e mesatares si funksionon dhe në lidhje me punësimin në momentin që më lind e drejta për punë. E kam lexuar marrveshjen por dua të jem pak më e qartë në lidhje me kto çështje. | 27.02.2024 | Përshëndetje,Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju sqarojmë se:<br>Studenti i cili ka zgjedhur të ndjekë studimet në një prej programeve të studimit, sipas emërtimeve në listën e programeve prioritare të miratuar me shtojcën nr.1 të VKM nr. 386/2022, të ndryshuar dhe është përfitues, mund të vijojë perfitimin e mbeshtetjes financiare në vitet në vijim pavarësisht notës mesatare.<br>Në mbështetje të VKM nr.386/2022, të ndryshuar, përcaktohet detyrimi i studentit që ka përfituar financim, qw të punojë në profesionin për jo më pak se 3 vite ne institucionet publike. Brenda 30 ( tridhjetë) ditëve pas diplomimit deri në përmbushjen e detyrimit për punësim, përfituesit duhet të aplikojnë për çdo pozicion të lirë pune në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe institucionet e pavarura publike.<br>Në institucionet, në të cilat marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, rekrutimi në pozicionet përkatëse i përfituesve kryhet me prioritet.<br>Përfituesit, sipas këtij vendimi, punësohen nga Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administrarës shtetërore, për gjithë kohëzgjatjen e detyrimit për punësim. Në rast mospunësimi deri në 6 (gjashtë) vite kalendarike nga dita e lindjes të së drejtës për punësim, studenti konsiderohet se i ka përmbushur detyrimet sipas këtij vendimi dhe ka të drejtën e tërheqjes së | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | diplomës origjinale nga institucioni publik i arsimit të lartë ku ka përfunduar studiment e financuara, sipas këtij vendimi.<br>Ju faleminderit! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 58 | 26.02.2024 | Pershendetje!<br>Une qe po ju shkruaj jam Antela Lika, gazetare ne emisionin Fiks Fare.<br>Po bej nje kronike mbi deget prioritare dhe pagesen qe studentet perfitojne si pjese e tyre.<br>Kush i ka perzgjedhur studentet qe do e marrin kete pagese?<br>Sa studente kane aplikuar nga Univesriteti Bujqesor i Kamzes?<br>Sa prej tyre e kane perfituar kete pagese?<br>A eshte rivendos kriter mesatarja per te perfituar pagesen?<br>Perse nuk po e marrin te gjithe aplikantet kete pagese?<br>Faleminderit!<br>Ne pritje te pergjigjes suaj! | 04.03.2024 | Përshendetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj ju informojmë se:Sipas VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, përzgjedhja e studentëve bëhet me vendim të Senatit Akademik të çdo universiteti, në rastin konkret nga Senati Akademik i Universitetit Bujqësor të Tiranës.Vendimi i Bordit Drejtues të AKFAL, nr.2, datë 08.02.2024, lidhur me “Miratimin e listës përfundimtare me të gjithë studentët që ndjekin studimet në peograme prioritare, të cilët përfitojnë mbështetje financiare për vitin akademik 2023-2024, sipas Vendimeve të Senateve Akademik të IAL-ve si dhe fondin përkatës”, është përcjellë në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.Ministria e Arsimit dhe Sporteve, sipas procedurave institucionale, e ka kaluar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Më pas, kjo Ministri e ka kaluar tek Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit Tiranë, Fondi i mbështetjes financiare ka kaluar në IAL-të përkatëse dhe po procedohet nga ana e tyre, për tu shpërndarë tek studentët përfitues të mbështetjes financiare të vitit akademik 2023-2024. Referuar Universitetit Bujqesor aktualisht jane ne proces nenshkrimi (refuzimi) te marreveshjeve dhe kur te kemi nje vendim senati te miratur prej tyre do tju njoftojme.<br>Sipas VKM nr 386/2022, i ndryshuar, për studentët aplikues që ndjekin studimet në programe prioritare, nuk ka kriter të notës mesatare. Në mbështetje të pikës 3/a të VKM nr.386/2022, të ndryshuar, mbështetjen financiare, e përfiton studenti për program të parë studimi dhe që pranon të nënshkruajë marrëveshje. Kështu që nuk mund të kemi një numër të saktë për përfituesit e Mbeshtejes Financiare per Universitetin Buqesor te Tiranes, pasi ka studentë të cilët kanë refuzuar nënshkrimin e marrëveshjes dhe po vijohet me procedurat sipas VKM nr.386/2022, të ndryshuar.<br>Ju faleminderit! | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 59 | 27.02.2024 | Pershendetje!<br>Ju lutem, kerkoj te informohem nese kredia studentore eshte e vlefshme per ciklin e 3-te te studimit (doktoraturat)?<br>Me respekt! | 06.03.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emailt tuaj ju informoj se:<br>Sipas VKM nr 440, datë 19.07.2023, “Për përcaktimin e skemës së kreditimit sudentor” përkatësisht pikës 7, gërmës “b”, dhe “c”,<br>b) lloji i programit të studimit ku është regjistruar studenti, i cili kërkon kredi. Nga kërkesat për kredi, të renditura sipas shkronjës “a”, preferohen kërkesat e paraqitura nga studentët e regjistruar në programe studimi, të përcaktuara si programe prioritare në institucione publike të arsimit të lartë, që plotësojnë detyrimin sipas pikës 6, të këtij vendimi, referuar akteve nënligjore në fuqi, si dhe në programe të tjera studimi, të ofruara nga institucione publike të arsimit të lartë;<br>c) rezultatet e studentit kërkues për kredi studentore. Kërkesat për kredi studentore, të cilat, sipas parashikimeve të dy pikave të mësipërme “a” dhe “b”, janë vlerësuar njëlloj të preferuara, do të renditen sipas nivelit më të lartë të rezultateve të studentit që kërkon kredi. Rezultate të studentit, sipas studimeve që ai ndjek, konsiderohen rezultatet, si më poshtë vijon:<br>i. Rezultatet e arsimit të mesëm të lartë, për studentët të cilët kërkojnë kredi studentore në vitin e parë të studimeve;<br>ii. Rezultatet e vitit/viteve akademik/e paraardhës/e, për studentët të cilët kërkojnë kredi studentore pas vitit të parë të studimeve për programet profesionale të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë. Për studentët pas vitit të dytë përllogaritja e notës mesatare bëhet si total i viteve të mëparshme të studimit;<br>iii.Rezultatet e ciklit të parë të studimeve për studentët që kërkojnë kredi kur janë regjistruar në një program studimi të ciklit të dytë, pavarësisht vitit që ndjekin,<br>Sa me siper, kredia studentore sipas VKM nr.440/2023, nuk parashikohet perfititimin e saj nga studentet qe ndjekin studimet ne ciklin e trete te studimeve.<br>Ju faleminderit! | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 60 | 28.02.2024 | Pershendetje, doja te dija ne cilen fasho oraresh operoni? | 04.03.2024 | Përshëndetje,<br>AKFAL ushtron veprimtarinë e tij në adresën: Rruga "Naim Frashëri", nr. 37, Tiranë, ju mund të paraqiteni në zyart tona nga E hënë- E enjte ora 8:00-16:30 dhe të premten ora 8:00-14:00.<br>Ju faleminderit | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 61 | 29.02.2024 | Përshëndetje! Uroj të jeni mirë! Në lidhje me aplikimin për kreditin studentore, tek forms fusha "Institucioni i arsmit të lartë" nuk të lejon përzgjedhje, kështu nuk mund të vazhdosh më tej për aplikimin. Duke ju falenderuar paraprakisht, mbetem në pritje të një përgjigjeje pozitive nga ana juaj. Punë të mbarë! | 29.02.2024 | Pershendetje,<br>Ky problem qendron ne disa raste nese behet aplikimi nga telefoni.<br>Nese aplikimi behet nga kompjuteri i lejon te gjitha pikat me perzgjedhje.<br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 62 | 29.02.2024 | Pershendetje! Kur mund te hidhen leket e burses per degen prioritare? | 11.03.2024 | Përshëndetje,<br>Në vijim të kërkësës suaj për informacion ju bëjmë me dije se ju keni plotësuar kriteret për të vijuar financimin edhe për vitin akademik 2023-2024, në përputhje me marrëveshjen trepalëshe të nënshkruar në vitin akademik 2022-2023.<br>Sa më sipër me qëllim informimin në lidhje me vijimin e financimit tuaj, lutemi të drejtoheni pranë Universitetit “ Fan.S.Noli”, Korçë.<br>AKFAL-i do të përcjellë kërkesën tuaj për informacion pranë Universitetit me qëllim trajtimin e kërkesës suaj.<br>Ju faleminderit! | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 63 | 29.02.2024 | Përshëndetje,<br>Në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në MAS është përcjellë kërkesa bashkëlidhur.<br>Sa më sipër, lutem trajtimin e kërkesës brenda afatit ligjor të parashikuar në ligjin nr.119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.<br>Faleminderit, | | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj ju informojme se:<br>Për vitin akademik 2023-2024, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit është dyfishuar financimi nga Buxheti i Shtetit për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe studentëve që ndjekin studimet në një program prioritar. Ky fond është vënë në dispozicion për 300 kuota gjithsej nga të cilat:<br>· 90 kuota për studentët e shkëlqyer (sipas numrit të aplikimeve ,të gjithë studentët të cilët kanë aplikuar për të përfituar mbështetje financiare sipas kriterit të përcaktuar në pikën 2/a të VKM nr.386/2022 të ndryshuar dhe që përmbushin kushtet kanë përfituar mbështetje financiare), nga të cilat 90 studentë janë përfitues nga 97 aplikime, ndërsa 7 studentë nuk plotësonin kriteret e vendosura ne VKM nr 386/2022.<br>· 210 kuota për studentët të cilët studiojnë në një program prioritar.<br>Numri i kuotave i shpërndarë në IAL-të publike në raport me përfituesit të cilët plotësojnë kriterin e VKM nr. 386/2022, të ndryshuar:<br>Universiteti i Tiranës 25 kuota , 120 përfitues<br>Universiteti Politeknik i Tiranës 14 kuota , 65 përfitues<br>Universiteti Bujqësor i Tiranës 80 kuota, 324 përfitues<br>Universiteti " Luigj Gurakuqi", Shkodër 14 kuota, 64 përfitues<br>Univeristeti " Aleksandër Xhuvani", Elbasan 13 kuota, 56 përfitues<br>Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës 25 kuota, 115 përfitues<br>Universiteti " Fan. S. Noli", Korçë 24 kuota, 95 përfitues<br>Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë 10 kuota, 44 përfitues<br>Universiteti " Eqerem Çabej", Gjirokastër 5 kuota, 25 përfitues<br>Ndërkohë në vitin akademik -2022-2023 fondi i vënë në dispozicion mbuloi financimin për 157 kuota nga të cilat<br>1. 70 kuota për studentët e shkëlqyer;<br>2. 87 kuota për studentët që studiojnë në program prioritare;<br>Më shkresë zyrtare janë informuar të gjitha IAL-të publike në lidhje me numrin e kuotave që janë vënë në dispozicion për secilën prej tyre në vitin akademik 2023-2024. Kuotat për mbështetjen financiare për secilën IAL në programe prioritare janë shpërndarë në përputhje më VKM nr 386/2022, të ndryshuar.<br>Në përfundim të procesit të aplikimit, nga | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | AKFAL, i është përcjellë lista e studentëve aplikues të cilët plotësojnë kriteret e VKM nr 386/2022, të ndryshuar, pika 2/c, si dhe lista e studentëve aplikues të cilët nuk plotësojnë kriteret e VKM nr.386/2022, të ndryshuar, secilës IAL ,me qëllim vijimin e përzgjedhjes së studentëve përfitues dhe shpërndarjen e këtyre kuotave.<br>Bazuar ne VKM nr386/2022,të ndryshuar, Senatet Akademike me vendim të tyre do të përcaktojnë shpërndarjen e kuotave sipas programeve prioritare që ata ofrojnë, si dhe do të përzgjedhin studentët përfitues nga lista totale, bazuar në notën mesatare në hyrje të këtyre studentëve, nëse numri i aplikimeve është më i madh se numri i kuotave për atë program.<br>Ju faleminderit! | | |
| 64 | 01.03.2024 | Përshëndetje!<br>Jam një studente e vitit të parë Bachelor në universitetin “Aleksandër Moisiu” dhe interesohesha për të aplikuar për një kredi studentore. Portali online që përmban aplikimin, nuk më lejon të plotësoj fushën e universitetit dhe të ciklit të studimit dhe kjo nuk më lejon të konfirmoj aplikimin.<br>Si mund të veproj rreth këtij problemi?<br>Faleminderit! | 09.03.2024 | Pershendetje ,<br>Ne pergjigje te kerkeses tuaj per informacion ju bejme me dije se:<br>Ne mebeshtetje te VKM nr.440/2023, procedura per perzgjedhjen e perfituesit te kredise do te behet brenda muajit Mars. Studenti që ka dërguar vlerën më të ulët, qe studion ne program prioritar si edhe ka rezultate me te larta është më i avantazhuar.<br>Suksese, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 65 | 04.03.2024 | Dua te bej kerkese per nje kopje te formularit qe kam plotesuar per bursat per deget prioritare.Keto jane te dhenat-> Emri:A.Q Dega: Mjeksi Veterinare Atesia:A.Q | 11.03.2024 | Përshëndetje,<br>Bashkangjitur do të gjeni kopjen e formularit tuaj të aplikimit të mbështetjes studentore. Formulari juaj i Aplikimit është protokolluar me nr.159/660 Prot., datë 13.11.2023.<br>Ju faleminderit | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 66 | 04.03.2024 | Pershendetje,<br>Shpresoj te jeni mire.<br>Une qe ju shkruaj quhem A.C, student i programit “Master in Area Studies” ne “Charles University”, Prage, Republiken Ceke.<br>Desha te interesohem rreth kredise studentore, me sekte nese kjo mundesi i ofrohet edhe studenteve te cilet sudiojne jashte Shqiperise? Arsimi ne bashkimin europian eshte rreth dy here me I shtrenjte per studentet nga vendet jo europiane, rrjedhimisht kjo mundesi do ishte nje ndihme shume e vlefshme.<br>Shpresoj te jete e mundur.<br>Duke pritur pergjigjen tuaj!<br>Gjithe te mirat. | 11.03.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj ju informojme se:<br>Bazuar në VKM nr.440/2023 “Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor” përkatësisht pikës 1,”Studenti, me shtetësi dhe vendbanim në Shqipëri, i cili është regjistruar dhe ndjek studimet në një institucion të arsimit të lartë, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për kredi studentore, për financimin e kostove të studimeve”<br>Ju nuk mund të jeni përfitues i skemës së kreditimit studentor.<br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 67 | 06.03.2024 | Pershëndetje!<br>Doja të dija se ku duhen dorezuar dokumentacionet e tjera si liste notash etj për të aplikuar për kredi studentore si dhe cila është një shifër e përafërt që është kandidate e mirë për t’u aprovuar si kredi.<br>Ju faleminderit paraprakisht! | 06.03.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj ju informojmë se:<br>Dorëzimi i dokumentave bëhet, dorazi, pranë Agjensisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë,adresa: Rruga “Naim Frashëri”, Nr. 37, Tiranë<br>Lista e dokumentave për aplikim:<br>1. Vërtetim që studenti ka shtetësi dhe vendbanim në Shqipëri<br>2. Vërtetim që studenti është regjistruar dhe ndjek studimet në një institucion publik të arsimit të lartë ( nr. Matrikullimi, lloji i programit të studimit) ( dokument origjjinal)<br>3. Kopje të diplomës/dëftesës së pjekurisë+ listë notash ( vërtetim- listë notash nga viti paraardhës nga IAL-ja ku studion)(dokumente të noterizuara.).<br>4. Vërtetim nga IAL-ja publike që nuk është përfitues i mbështetjes financiare/bursave/përjashtimi nga tarifa e studimit (dokument origjinal)<br>Kostoja e studimeve përfshin, tarifën e studimeve dhe kostot e jetesës e cila përllogaritet deri në kufirin e pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, në masën 40.000 në muaj.<br>Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, brenda muajit mars, vlerëson dhe rendit kërkesat e studentëve për kredi studentore duke, preferuar kërkesat me vlerën më të ulët të kredisë.<br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 68 | 09.03.2024 | Pershendetje,<br>Dua t'ju pyes ne lidhje me bursat e ekselences. Ka informacion se kur mund te kalojne fondet ne llogarite individuale te studenteve perfitues? | 11.03.2024 | Përshëndetje,<br>Në vijim të kërkësës suaj për informacion ju bëjmë me dije se ju  keni plotësuar kriteret për të vijuar financimin edhe për vitin akademik 2023-2024, në përputhje me marrëveshjen trepalëshe të nënshkruar në vitin akademik 2022-2023.<br>Sa më sipër me qëllim informimin në lidhje me vijimin e financimit tuaj, lutemi të drejtoheni pranë Universitetit  të Mjekësisë,Tiranë<br>AKFAL-I do të përcjellë kërkesën tuaj për informacion pranë Universitetit me qëllim trajtimin e kërkesës suaj.<br>Ju faleminderit!<br><br>**Drejtuar Universitetit të Mjekësisë, Tiranë**<br>Përshëndetje.<br>Në përputhje me nenin 12, të ligjit 119/2014, të ndryshuar, si dhe referuar marrëveshjes trepalëshe të nënshkruar për vitin akademik 2022-2023, përcjellim për trajtim kërkesën për informacion të studentes.<br><br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 69 | 19.03.2024 | Përshëndetje,<br>Uroj ky email Ju gjen mirë.<br>Në platformën e Bashkëqeverisjes është depozituar ankesa e qytetarit Nik Jahja si më poshtë vijon.<br>Lutemi nga ana juaj një informacion mbi sa qytetari parashtron.<br>Duke ju uruar punë të mbarë.<br>Në pritje të përgjigjes tuaj brenda afateve të vendosura më poshtë.<br>Faleminderit<br>Elda Liksala | 20.03.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj ju informojmë se:<br>Në mbështetje të VKM 386/2022, të ndryshuar," Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet e arsimit të lartë", shtojca 1, programi i studimit "Gjuhë Letërsi" është program studimi që përbën prioritet kombëtar.<br>Në pikës 6/1 te VKM 386/2022, të ndryshuar, përcaktohet se: "Përzgjedhja e studentëve përfitues për programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, bëhet sipas kuotave të miratuara çdo vit për mbështetje financiare, për çdo IAL publike, nga ministri përgjegjës për arsimin dhe fondit në dispozicion për vitin përkatës financiar. Institucionet publike të arsimit të lartë i caktojnë këto kuota me vendim të Senatit Akademik për çdo program prioritar që ato ofrojnë, në përpjesëtim të drejtë me numrin e studentëve për çdo program dhe i përzgjedhin ato në bazë të renditjes, sipas notës mesatare në pranim, nëse numri i kërkuesve është më i madh se kuotat e ofruara. Vendimi i Senatit Akademik për shpërndarjen e kuotave për çdo program dhe për përzgjedhjen e studentëve përfitues i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë"<br>Përzgjedhja e studentëve përfitues në programet që përbëjnë prioritet kombëtar, caktohet me vendim të Senatit Akademik të IAL përkatëse në rastin tuaj të Universitetit " Luigj Gurakuqi", Shkodër.<br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 70 | 28.03.2024 | Përshëndetje,<br>Desha të bëj kërkesën për aplikimin e kredisë studentore. Jam në vit të parë bachelor në Akademinë e Arteve. E kam program të dytë studimi e ndaj tarifa e shkollimit është më e lartë, rreth 220000 në vit. E kryej tani aplikimin pasi mu vonua numri i matrikullimit.<br>Si mund të më ndihmoni ju lutem.<br>Gjithë të mirat,<br>Rigelsa | 03.04.2024 | Përshendetje,<br>Në mbështetje të VKM nr.440/2023 si dhe Njoftimit Publik " Për aplikimin e studentëve të interesuar, për të përfituar nga skema e kreditimit studentor",<br>Afatet për të aplikuar per Kredinë studentore kanë përfunduar.<br>Ju faleminderit | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 71 | 17.04.2024 | Pershendetje!<br>Jam Hava Likaj, studente e kimise se vitit te dyte, bachelor. Une jam perfituess e burese per deget prioritare. Lutem te me bashkangjisni nje kopje te kontrates per kete burse.<br>Faleminderit! | 24.04.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se:<br>Ju duhet të paraqiteni fizikisht pranë zyrave të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, me kartën tuaj të identitetit, të tërhiqni kopjen tuaj tuaj të marrëveshjes.<br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 72 | 18.04.2024 | Pershendetje, Une dhe bashkeshorti im jemi ish maturante dhe kete do te vazhdojme universitetin. Me mesatare 8.6 dhe 8.4 1)Per sa i perket burses nga zgjedhja e degeve prioritare kete vit kush perfiton 40.000 mije leke?Te gjithe studentet qe zgjedhin ato dege eshte vendosur kuote? 2)Jemi bashkeshorte me nje femije, e perfitojme bursen 10.000 leke gjithashtu dhe heqje tarife? Faleminderit paraprakisht. | | Përshëndetje,<br>Në vijim të kerkeses tuaj per informacion ju sqarojme se:<br>Mbi perfitimin e mbështetjes fiannciare në masën e pagës minimale te miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave, në mbështetje të VKM nr.386/2022, të ndryshuar, ju bejme me dije se:<br>Sipas pikës 2/c, të VKM nr. 386, datë 1.6.2022, të ndryshuar "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", mbështetjen financiare e përfiton studenti i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar.<br>Në pikën 6/1 të VKM nr. 386, datë 1.6.2022, i ndryshuar përcaktohet se përzgjedhja e studentëve përfitues për programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, bëhet sipas kuotave të miratuara çdo vit për mbështetje financiare, për çdo IAL publike, nga ministri përgjegjës për arsimin dhe fondit në dispozicion për vitin përkatës financiar.<br>Institucionet publike të arsimit të lartë i caktojnë këto kuota me vendim të Senatit Akademik për çdo program prioritar që ato ofrojnë, në përpjesëtim të drejtë me numrin e studentëve për çdo program dhe i përzgjedhin ato në bazë të renditjes, sipas notës mesatare në pranim, nëse numri i kërkuesve është më i madh se kuotat e ofruara. Vendimi i Senatit Akademik për shpërndarjen e kuotave për çdo program dhe për përzgjedhjen e studentëve përfitues i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.<br>Mbi perfitimin e mbështetjes fiannciare në masën 10.000 lekë, në mbështetje me VKM nr.903/2016, të ndryshuar, ju bejme me dije se:<br>Sipas VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", përfitojnë bursë nga fondi i mbështetjes studentore, në masën e përcaktuar në këtë vendim, studentët e pranuar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve, si dhe studentët e shtresave sociale në nevojë, që plotësojnë kriteret e paarshikuara ne kete akt.<br>Sa me siper bashkelidhur ju percjellim per njohje VKM nr. 386/2022, të ndryshuar, si dhe VKM nr. Nr. 903, datë 21.12.2016.<br>Ju faleminderit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 73 | 24.04.2024 | Përshëndetje,<br>U njoftova që është dërguar një email për vijueshmërinë e kredisë studentore disa studentëve.<br>Lutem mund të më informoni në çfarë faze është aplikimi im dhe nëse ka ndonjë dokument që nuk është plotësuar?<br>Faleminderit.<br>Kalvin Dermyshi | 29.04.2024 | Në përgjigje të emaili tuaj ju bëjmë me dije se:<br>Ju keni aplikuar në portalin online për te përfituar nga skema e kreditimit studentor.<br>Aplikimi juaj është regjistruar me tonën nr.127 prot., datë 12.03.2024, dhe rezulton se ju keni dorëzuar me postë dokumentacioni e kërkuar në datë 18.03.2024.<br>Referuar pikës 1, 6, të VKM nr.440/2023, si dhe Njoftimit Publik nr. 44/2 datë 19.02.2024, "Për aplikimin e studentëve të interesuar, për të përfituar nga skema e kreditimit studentor", lista e dokumentave të cilat studenti kërkues duhet të depozitojë fizikisht pranë AKFAL janë:<br>1. Vërtetim që studenti ka shtetësi dhe vendbanim në Shqipëri;<br>2. Vërtetim që studenti është regjistruar dhe ndjek studimet në një institucion publik të arsimit të lartë (nr. Matrikullimi, lloji i programit të studimit) (dokument origjinal);<br>3. Kopje të diplomës/dëftesës së pjekurisë+ listë notash (vërtetim- listë notash nga viti paraardhës nga IAL-ja ku studion) (dokumente të noterizuara.);<br>4. Vërtetim nga IAL-ja publike që nuk është përfitues i mbështetjes financiare/bursave/përjashtimi nga tarifa e studimit (dokument origjinal).<br>Sipas relacionit të Grupit të Punës të ngritur pranë AKFAL, i cili ka verifikuar dokumentacionin e dorëzuar nga ana juaj, rezulton se ju jeni renditur i 15, në listën e studentëve që përmbushin kriteret për të përfituar nga skema e kreditimit studentor, sipas pikës 1, 6, VKM-së nr.440/2023.<br>Sa më sipër, ju do të njoftoheni në vijim mbi aplikimin tuaj.<br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 74 | 04.05.2024 | Pershendetje si jeni.<br>Dua te di te gjitha kriteret dhe dokumentat q duhen per nje kredi studentore pasi jam shum e interesuar. Dua te di neqoftese kerkohet qe te kesh ndonje muaj siguracion pune ose ndonje vertetim i atille pasi nuk kam punuar kurre me siguracione.<br>Pres pergjigjen tuaj sa me shpejt.<br>Faleminderit. | 08.05.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj ju informojmë se:<br>Në nenin 114 të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", është parashikuar e drejta për aplikim për të pwrfituar kredi studentore, për të gjithë studentët që fitojnë të drejtën për studime në programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë.<br>Nëpërmjet Vendimit nr. 440/2023, "Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor", Këshilli i Ministrave ka miratuar kushtet, kriteret dhe procedurat për të përfituar nga kjo skemë.<br>Gjithahstu, referuar kushteve që duhet të plotësojnë studentët që mund të përfitojnë nga skema e kreditimit studentor, e konkretisht në pikën 1 dhe 6, të VKM nr.440/2023, ju bëjmë me dije se nuk nevojitet asnjë vërtetim në lidhje me punësimin e studetëve.<br>Kredia studentore financon kostot e studimeve, të cilat për efekt të masës së kredidhënies, përfshin tarifën e studimeve dhe kostot e jetesës.<br>Bashkëlidhur ju përcjellim për njohje VKM nr.440/2023.<br>Mbetemi të hapur për çdo paqartësi,<br><br>Ju faleminderit | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 75 | 17.05.2024 | Përshëndetje,<br>Unë quhem Albona Leka dhe jam studente në vitin e parë Bachelor në degën e Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës.<br>Në kuadër të një detyre kursi që po kryej mbi Kredinë Studentore, bazuar dhe në të dhënat e siguruara nga website-i juaj, s'mund të mos vija re se numri i aplikimeve për kredi nga studentët, dhe veçanërisht ai i dorëzimeve të tyre sipas procedurës, është tejet i ulët.<br>Pa hyrë në analizë se pse ka ndodhur kjo, dhe duke e marrë të mirëqenë se biem në një mendje lidhur me konstatimin tim të mësipërm, doja të pyesja:<br>1. A keni vendosur ju një minimum numri studentësh aplikantë, nga ku zbatimi i ligjit për Kredinë Studentore të fillojë?<br>Për rrjedhojë,<br>2. A do ta përfitojnë ende Kredinë 15 studentët që kanë dorëzuar dokumentacionet këtë vit?<br>Dhe e fundit,<br>3. Keni projektuar ndonjë ndryshim në planifikim për vijimësinë e mënyrës së funksionimit të këtij ligji, bazuar në rezultatet e përftuara këtë herë të parë?<br>Do të jem në pritje të përgjigjes suaj.<br>Faleminderit parapraktisht! | 21.05.2024 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije se:<br>Referuar VKM nr. 440, datë 19.07.2023, “ Për përcaktimin e skemës së kreditimit sudentor” , pikës nr.1 të saj  ku  shprehet se “Studenti, me shtetësi dhe vendbanim në Shqipëri, i cili është regjistruar dhe ndjek studimet në një institucion të arsimit të lartë, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për kredi studentore, për financimin e kostove të studimeve.”Bazuar në Njoftimit Publik nr. 44/2 datë 19.02.2024, “Për aplikimin e studentëve të interesuar, për të përfituar nga skema e kreditimit studentor”, do të përfitojnë nga skema e kreditimit studentor,.studentët aplikues që kanë dorëzuar fizikisht, pranë AKFAL, dokumentacion të rregullt .Procesi i kreditimit studentor nuk ka përfunduar ende. Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 76 | 20.06.2024 | Pershendjetje<br>Jam nje maturant me  mestaren e tre viteve 10.00. Nese apikoj per bursen e ekselences pasi te jem rregjistruar ne programin “Mjekesi e Pergjithshme” dhe firmos kontraten, dhe pas studimeve filloj specializimin ne nje spital publik, a quhet pune ne insititucion publik specializimi? Sepse Fakulteti i Mjekesise specializimet i kryen ne institucione publike.<br>Ne pritje te pergjigjes tuaj | 01.07.2024 | Pershendetje,<br>Ne pergjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se:<br>Në mbështetje me pikën 2, të VKM nr.386/2022, të ndryshuar, mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, të studentëve shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë, që nuk janë njëkohësisht përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar.<br>Detyrimi i punësimit pas përfundimit të studimeve, është 3 (tre) vjet sipas parashikimeve në VKM nr. 386/2022, të ndryshuar. Do të konsiderohen si pezullim i detyrimeve të punësimit të përfituesit periudhat e studimeve të vazhduara në vijimësi, në programet e studimit të ciklit të tretë, si: Master Ekzekutiv, Doktoratë apo specializime afatgjata, sipas kuadrit ligjor në fuqi, në fushën për të cilën ai ka marrë financim, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, pas miratimit me shkrim.<br>Ju faleminderit | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 77 | 11.07.2024 | Përshendetje! Sapo lexova Vendimin e rri te Keshillit te Ministrave ne lidhje me deget prioritare. Une jam perfituese e burses per degen prioritare dhe sapo kam mbaruar vitin e pare, por tek kontrata qe kam firmosur nuk ishte kriteri i mesatares, kurse tek vendimi i rri qe eshte marre eshte kriteri i mesatares. Doja te dija neqoftese kjo vlen vetem per vitet e para apo dhe per vitet e dyta te cilet kane marre 1 vit burse? | 21.07.2024 | Pershendetje,<br>Ne pergjigje te kerkeses tuaj per informacion ju bejme me dije se:<br>Ju do te vijoni te perfitoni mbeshtetje financiare sipas kushteve te percaktuara ne marreveshjen trepaleshe te nenshkruar nga ana juaj.<br><br>Ju falemiderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 78 | | Pershendetje! Deshiroj te di se si do vazhdoj pagesa e burses per degen prioritare gjate viteve te masterit.<br>Faleminderit! | | Pershendetje,<br>Ne pergjigje te kerkeses tuaj per informacion ju bejme se:<br>Ne mbeshtetje me VKM nr.386/2022 te ndryshuar, studenti me qëllim vijimin e financimit,duhet të plotesoje kushtet e parashikuara ne marreveshjen trepaleshe gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të ciklit të parë dhe të dytë ose gjatë ndjekjes së studimeve të integruara të ciklit të dytë në institucionin publik të arsimit të lartë.<br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 79 | 26.07.2024 | Pershendetje si jeni? Jam nje studente ne vitin e dyte qe studioj nje nga deget prioritare. Kam firmosur kontraten e burses, por doja te dija qe pas ciklit bachelor mund te vazhdoj master shkencor apo eshte e detyruar te vazhdoj master professional? Dega ime eshte Biologji. | | Pershendetje,<br>Ne pergjigje te kerkeses tuaj per informacion ju bejme se:<br>Ne mbeshtetje me VKM nr.386/2022 te ndryshuar, studenti me qëllim vijimin e financimit,duhet të plotesoje kushtet e parashikuara ne marreveshjen trepaleshe gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të ciklit të parë dhe të dytë ose gjatë ndjekjes së studimeve të integruara të ciklit të dytë në institucionin publik të arsimit të lartë.<br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 80 | 02.08.2024 | Pershendetje , Jam I.M.N Student i Universitetit Te Arteve , Jam shpallur perfitues I skemes Akfal , dhe pas shume datash shtyrje , me 15 Korrik na njofton Intesa San Paolo Bank, Na njoftojn me ca rregulla qe eshte jashte cdo rregulli qe ministria e arsimit ka dhen duke futur bashkekredimarrës prinderit , si nje student qe e kam ndjek hap pas hapi dhe kam dorzu cdo gje erdhen dhe prinderit , firmosem te gjithe te punesuar dhe me biznes + , dhe cdo dite ata vazhdojne dhe nxjerin kerkesa te reja qe nuk perputhen me nje bank serioze dhe nje ofendim per studentet.<br>Ju lutem pres nje pergjigje dhe nje interesim mga ana juaj per këtë skem mashtrimi jasht cdo rregulloreje te nje kredie minimale per nje student te shkelqyer qe po ben INTESA SAN PAOLO BANK ALBANIA. Nje mos seriozitet mga te dyja palët edhe mga punonjesit e AKFAL qe mbyllin telefonin apo shprehen se banka nuk u kthen pergjigje , duke mos mar parasysh noterizimet dhe firmat e dekanit , rektorit dhe shume Harxhime e mundime te tjera.<br>Ju lutem Shikojeni kete rast sepse po luhete te ardhmen e studentve Fitues, | 07.08.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të ankeseës së studentit Iger Nurellari, te përcjell nga ana juaj ju bëjme me dije se:<br>Agjencia Kombetare e Fianncimit te Arsimit te Larte negocion me banken e nivelit te dyte ne lidhje me kushtet e percaktuara ne VKM nr.440/2023. Sipas pikës 4 të VKM nr.440/2023, përcaktohet se kushtet e tjera përcaktohen nga palët, kërkuesit për kredinë studentore dhe banka e nivelit të dytë, në kontratën e kredisë së lidhur ndërmjet tyre.<br>Ne përfundim, në mbështetje të pikes 12 te VKM nr.440/2023, si dhe ne zbatim të Kontratës së nënshkruar ndërmjet AKFAL dhe Bankës Intesa San Paolo Bank, më datë 02.08.2024, Banka ka përcjellë pranë AKFAL në rrugë elektronike Marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet saj dhe Studentit Iger Nuellari.<br>Ju faleminderit, | Trajtuar, kerkesa eshte percjelle per trajtim nga kordinatori i MAS | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 81 | 19.08.2024 | 1-Sa është numri aktual i nxënësve në shkollat e vendit (arsimi fillor, i mesëm dhe universitete)<br>2- A ka mungesa për mësues në profile të caktuar, si psh: Matematik, Fizikë, Kimi, etj, dhe sa është<br>numri i përgjithshëm i mësuesve mungesë?<br>3- Sa shkolla janë mbyllur nga vitit 2014 e deri në vitin 2024 për shkak të mungesës së nxënësve?<br>4- Sa është rënia e numrit të nxënësve nga vitit 2014 e deri më sot?<br>5- Sa është numri klasave kolektive në të gjithë territorin e vendit?<br>6- Sa është numri i nxënësve që përfituan pagesën nga programet prioritare gjatë vitit 2023?<br>7- Sa nxënës pritet të përfitojnë bursa nga programet prioritare gjatë vitit 2024-2-25? | 25.08.2024 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj ju informojme se:<br><br>Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë bazuar në fushën e saj të veprimtarisë, ju përcjell informacion për pyetjen 6 dhe 7.<br>Pyetja 6: Sa është numri i nxënësve që përfituan pagesën nga programet prioritare gjatë vitit 2023?<br>Viti 2023 përfshin 2 (dy) vite akademike, konkretisht vitin akademik 2022-2023 dhe 2023-2024, për këtë arsye informacioni për studentët përfitues që ndjekin studimet në programe prioritare, në përputhje me parashikimet e VKM nr.386/2022, të ndryshuar janë kategorizuar, si më poshtë:<br>1- Studentë të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen për përfitimin e mbështetjes financiare për vitin akademik 2022-2023 dhe vitet akademike në vijim:<br>a) Për vitin akademik 2022-2023, periudha Janar-Korrik 2023, kanë përfituar 87 studentë.<br>b) Për vitin vijues akademik pas vitit 2022-2023, konkretisht viti akademik 2023-2024, plotësuan kushtet për vijimin e financimit për periudhën Tetor-Dhjetor 2023, 26 studentë.<br>2- Studentë të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen për përfitimin e mbështetjes financiare për vitin akademik 2023-2024 dhe vitet akademike në vijim, për periudhën Tetor-Dhjetor 2023, përfituan 208 studentë.<br>Pyetja 7: Sa nxënës pritet të përfitojnë bursa nga programet prioritare gjatë vitit 2024-2025?<br>Në mbështetje me VKM nr.386/2022, të ndryshuar do të realizohet verifikimi për vijimin e financimit për vitin akademik 2024-2025, për studnetët të cilët plotësojnë kushtet sipas marrëveshjes së nënshkruar nga ana e tyre në vitin akademik 2022-2023 dhe vitin akademik 2023-2024, në total 295 studentë potencial për fianncim.<br>Gjithashtu, sipas pikës 6/1 të VKM nr.386/2022 të ndryshuar me Vendimin nr.1, datë 31.07.2024, Komisioni ad Hoc, ka përcaktuar programet prioritare të studimit dhe 100 kuota financimi për këto programe për vitin akademik 2024-2025.<br>Ju faleminderit, | Trajtuar, kerkesa eshte percjelle per trajtim nga kordinatori i MAS | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 82 | 18.09.2024 | Përshëndetje! Jam student në vitin e tretë mjekësi dhe mbarova vitin e dytë me mesatare 9.5. A e përfitoi bursën sa paga minimale? Faleminderit. | 19.09.2024 | Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se:<br>Në mbështetje me pikën 2 të Vendimit nr. 386, datë 1.6.2022 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, e përfitojnë studentët shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë në atë vit akademik kur aplikohet.<br>Mbështetjen financiare e përfiton studenti për program të parë studimi dhe që ka nënshkruar marrëveshje, ndërmjet përfituesit të financimit apo përfaqësuesit ligjor të tij, institucionit të arsimit të lartë, ku pranohen për të kryer studimet, dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, për përfitimin e financimit në Republikën e Shqipërisë.<br>Referuar kërkesës tuaj ju shpreheni se keni përfunduar vitin e 2 (dytë) të studimeve, sipas verifikimit të kryer nga ana jonë rezulton se:<br>Ju nuk keni nëshkruar marrëveshjen tre palëshe në viti akademik 2022-2023, në këto kushte ju nuk jeni subjekt i përfitimit sipas VKM nr.386/2022, të ndryshuar .<br>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, | Trajtuar, kerkesa eshte percjelle per trajtim nga kordinatori i MAS | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 83 | 27.09.2024 | Pershendetje! Kete vit futem si studente e vitit te pare ne degen Mjekesi e Pergjithshme ne Universitetin e Mjeksise Tirane(UMT). Isha e interesuar ne lidhje me bursen 40 000. Kam te tre vitet e gjimnazit me mesatare 10.0, jam fituese e Medaljes se Arte, dhe kam fituar vendin e dyte ne Olimpaden Kombetare te Kimise 2024. A kualifikohem per te perfituar ne kete burse (40 000) ?Pershendetje! Kete vit futem si studente e vitit te pare ne degen Mjekesi e Pergjithshme ne Universitetin e Mjeksise Tirane(UMT). Isha e interesuar ne lidhje me bursen 40 000. Kam te tre vitet e gjimnazit me mesatare 10.0, jam fituese e Medaljes se Arte, dhe kam fituar vendin e dyte ne Olimpaden Kombetare te Kimise 2024. A kualifikohem per te perfituar ne kete burse (40 000) ? | 01.10.2024 | Pershendetje,<br>Sipas VKM nr.386/2022, i ndryshuar, mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, të studentëve shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë, që nuk janë njëkohësisht përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme:<br>a) Studenti me notë mesatare në pranim, që:<br>i. ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00;<br>ii. në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00.<br>b) Studenti fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/t/disiplinën ku ka fituar çmimin;<br>c)Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar, të përcaktuara nga komisioni ad hoc, i ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, për çdo vit akademik, sipas fushave të studimit të miratuara në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi<br><br>Ju faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 84 | 06.10.2024 | Pershendetje si jeni? Jam Denisa Dervishaj. Kerkoj ju lutem nje kopje te kontrates time te mbeshtetjes financiare qe kam marre gjate vitit 2022-2023, si studente me mesatare 10.0 nga gjimnazi dhe cdo provim mbi 9.5.<br>Kerkese kjo pasi kam humbur dokumentin tim origjinal. Nqs eshte e mundur mund te paraqitem dhe fizikisht.<br>Faleminderit! | 16.10.2024 | Pershendetje,<br>Ne vijim te kerkeses tuaj lutemi te paraqiteni prane zyrave te AKFAL ne adresen: Rruga "Naim Frasheri", nr.37, Tirane, per te terhequr kopjen e marreveshjes te njesuar me origjinalin. Ju mund te paraqiteni nga e hena - te enjte ora 8:00- 16:30, dhe te premten ora 8:00-14:30.<br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 85 | 16.10.2024 | Pershendetje. Jam nje studente ne vitin e pare Mjeksi e Pergjithshme. Sipas kritereve perfitoj bursen sa paga minimale. Ne zyrat e AKFAL duhet te dorezoj vetem aplikimin apo nevojiten edhe dokumente te tjera?<br>Faleminderit. | 23.10.2024 | Pershendetje,<br>Ne vijim te kekreses tuaj per me teper informacion bashkelidhur ju percjell linkun me shpalljen e thirrjes per aplikimet per mbeshtetje fiannciare per vitin akademik 2024-2025.<br>https://akfal.gov.al/en/news/2024/10/14/njoftim-p%C3%ABr-paraqitjen-e-aplikimeve-p%C3%ABr-t%C3%AB-p%C3%ABrfituar-mb%C3%ABshtetje-financiare-nga-student%C3%ABt-e-regjistruar-n%C3%AB-vitin-akademik-2024-2025/<br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 86 | 22.10.2024 | Pershendetje !<br>A mundem te lutem me shume info rreth aplikimit qe do behet tek ju ose te me dergoni kushtet e kontrates per te aplikuar? | 23.10.2024 | Pershendetje,<br>Bashkelidhur ju percjell linkun i cili permban te dhenat e nevojshme per aplikimet per mbeshteje fiannciare.<br>https://akfal.gov.al/en/news/2024/10/14/njoftim-p%C3%ABr-paraqitjen-e-aplikimeve-p%C3%ABr-t%C3%AB-p%C3%ABrfituar-mb%C3%ABshtetje-financiare-nga-student%C3%ABt-e-regjistruar-n%C3%AB-vitin-akademik-2024-2025/<br>Gjithashtu, gjeni bashkelidhur dhe VKM nr.386/2022, i ndryshuar, mbi kushtet dhe kriteret qe duhet te plotesojne studentet.<br>Falemidnerit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |
| 87 | 13.12.2024 | Përshendetje dua të dij dokumentat që më duhen për të përfituar bursë<br>Kriteri që plotësoj është dega prijoritet kombëtar . | 13.12.2024 | Pershendetje,<br>Aplikimet per te qene te vlefshme, referuar dhe shpalljes publike duhen dorezuar dorazi ose ne rruge postare prane AKFAL.<br>Sa me siper, per me teper informacion bashkelidhur ju percjellim shpalljen publike per fillimin e aplikimeve.<br>https://akfal.gov.al/en/news/2024/10/14/njoftim-p%C3%ABr-paraqitjen-e-aplikimeve-p%C3%ABr-t%C3%AB-p%C3%ABrfituar-mb%C3%ABshtetje-financiare-nga-student%C3%ABt-e-regjistruar-n%C3%AB-vitin-akademik-2024-2025/<br>Aplikimi perfundon me date 16.12.2024<br>Faleminderit, | Pergjigjia jepet e plote | JO |